 SHKOLLA E LARTË HËNA E PLOTË-BEDËR	RREGULLORJA STUDIMEVE TË CIKLIT TË PARË				
	DHE PROVIMEVE				
	Kodi i dokumentit	Data e publikimit	Nr. i përditësimit	Data e përditësimit	Faqe/Total
	BU-REG-004-AL	01.10.2012	0	0	1 / 11

Dispozita të Përgjithshme

NENI 1 – Arsimimi dhe testimi ne fakultetet dhe departamentet e Shkollës së Lartë “Hëna e plotë” (Bedër) behet duke u bazuar ne dispozitat e kesaj Rregulloreje.

Baza Ligjore

NENI 2 – Kjo Rregullore nxirret në bazë dhe për zbatim të Ligjit `Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë` dhe të Statutit të Shkollës së Lartë “Hëna e plotë” (Bedër).

Diploma

NENI 3 - Studentët të cilë përfundojnë me sukses studimet në fakultetet e Shkollës së Lartë “Hëna e plotë” (Bedër), në zbatim dhe në përputhje të kësaj Rregulloreje, pajisen me diplomën përkatëse universitare e cila përban emërtimin e fakultetit dhe departamentit. Senati përcakton titujt që do të jepen në përfundim të studimeve për fakultetet dhe departamentet e reja që do të hapen/formohen në të ardhmen.

Çështjet Studentore

NENI 4 - Per sa i perket çështjeve të transferimit të studentëve, çështjeve që lidhen me arsimin dhe provimet si dhe ato që kanë të bëjnë me shkëputjen e marrëdhënieve me fakultetin, vendimmarrja i takon Këshillit të Administrimit të Fakultetit. Në këto raste, studenti ka të drejtë të ankimojë vendimin në Këshillin e Administrimit të Shkollës së Lartë, brenda 15 ditëve.

Për çështjet e disiplinës, zbatohet `Rregullorja e Disiplinës e Shkollës së Lartë “Hëna e plotë” (Bedër).

Pranimi dhe Regjistrimi


NENI 5 – Shkolla e Lartë “Hëna e plotë” (Bedër) kryen pranimi e studentëve duke i kushtuar rëndësi dhe vëmendje gjendjes së suksesit të tyre.

Studentët shqiptar pranohen në Shkollën e Lartë në bazë të mesatares së shkollës së mesme dhe nëse gjykohet e nevojshme në bazë të provimit të pranimit të organizuar nga Shkolla.

Pranimi i studentëve të huaj bëhet në bazë të te rezultateve të provimeve kualifikuese në shtetin e tyre, nëse ka, dhe rezultateve të studimeve të shkollës së mesme.

Gjatë regjistrimit studenti nënshkruan me Shkollën e Lartë kontratën e arsimimit. Studenti angazhohet se gjatë të gjithë periudhës së studimit do të zbatojë Rregulloret, Udhëzimet e Shkollës së Lartë “Hëna e plotë” (Bedër) dhe legjislacionin përkatës të Republikës së Shqipërisë në fushën e arsimit.

Datat përfundimtare të regjistrimit, dokumentacioni i nevojshëm dhe rregullat që duhen zbatuar përcaktohen nga Keshilli Drejtues i Universitetit dhe publikohen. Aplikantët pasi plotësojnë të

 SHKOLLA E LARTË HËNA E PLOTË-BEDËR	RREGULLORJA STUDIMEVE TË CIKLIT TË PARË DHE PROVIMEVE				
	Kodi i dokumentit	Data e publikimit	Nr. i përditësimit	Data e përditësimit	Faqe/Total
BU-REG-004-AL	01.10.2012	0	0	2 / 11	

gjitha procedurat e nevojshme për regjistrim, behet student i Shkollës së Lartë “Hëna e plotë” (Bedër) dhe si I tillë përfiton nga të gjitha të drejtat e studentit. Aplikantët të te cilet nuk kryejne regjistrimit brenda afatit të përcaktuar prej Fakultetit, quhen sikur kanë hequr dore dhe nuk mund të kërkojnë më asnjë të drejtë. Në rast se aplikanti për shkaqe të arsyeshme nuk mund të kryejë vetë regjistrimin, atëhere një i afërm i tij mund t’i ndjekë procedurat. Në rast se dokumentet e paraqitura nga studenti janë të gabuara ose të mangeta, marredhieniet e tij me Shkollën e Lartë “ Hëna e Plotë BEDËR” ndërpriten, pa u marrë parasysh semestri të cilin ai ndjek.

Këshillimi akademik

NENI 6 – Departamenti përkatës zgjedh një pedagog këshilltar, për cdo student. Këshilltari, ndjek dhe udhëzon studentin mbi anën akademike, gjatë periudhës studimore. Këshilltari miraton formularët e regjistrimit semestral për cdo student përkatës.

Përtëritja e Rregjistrimit

NENI 7 - Studentët që ndjekin studimet në Shkollën e Lartë “Hëna e plotë” (Bedër), janë të detyruar të përtërijnë rregjistrimet e tyre semestrale brenda kushteve të përcaktuara nga Këshilli i Administrimit të Fakultetit. Përtëritja e rregjistrimit, bëhet në afatet e caktuara në kalendarin akademik.


Në rast se studentët nuk kanë shlyer pagesën e arsimimit sipas kushteve të përcaktuara nga Shkolla e Lartë, atëherë ata nuk mund të përtërijnë rregjistrimin semestral. Studentët të cilët nuk kanë përtërirë rregjistrimin nuk mund të ndjekin procesin mësimor dhe as të hyjnë në provime. Semestri për të cilin nuk është kryer pagesa arsimore do të llogaritet brenda periudhës studimore. Marrëdhëniet me studentin ndërpriten, në rast se nuk përtërihet rregjistrimi për dy semestra të njëpasnjëshëm. Në rast se studenti nuk shlyen në kohë pagesën, ai është i detyruar të paguajë penalitetet vonese 10% për cdo muaj që nuk kryhet pagesa.

Karta e Studentit

NENI 8 – Studentët pajisen me një Kartë Studenti me fotografi, të vlefshme jo më shumë se një vit, në rast se kanë plotësuar regjistrimin bazuar në nenin 5 të kësaj rregulloreje dhe në rast se kanë kryer përtëritjen e regjistrimit në zbatim të nenit 7.

Transferimet në Institucionet e Arsimit të Lartë

NENI 9 - Këshilli i Administrimit të Fakultetit përkatës, vendos për transferimet të cilat kryhen në fakultetet e Shkollës së Lartë “Hëna e plotë” (Bedër). Ky Këshill kryen të gjitha procedurat përkatëse të ekuivalentimit.

 SHKOLLA E LARTË HËNA E PLOTË-BEDËR	RREGULLORJA STUDIMEVE TË CIKLIT TË PARË				
	DHE PROVIMEVE				
	Kodi i dokumentit	Data e publikimit	Nr. i përditësimit	Data e përditësimit	Faqe/Total
BU-REG-004-AL	01.10.2012	0	0	3 / 11	

Në përputhje me këtë nen, studentët të cilët kanë kryer procedurat e ekuivalentimit në, pajisen me diplomë vetëm në rast se kanë ndjekur jo më pak se dy semestra studimet pranë fakulteteve të Shkollës së Lartë “Hëna e plotë” (Bedër).

Arsimimi

NENI 10 - Viti akademik përbëhet nga semestri i vjeshtës dhe i pranverës. Kohëzgjatja normale e semestrit të vjeshtës dhe të pranverës përkatësisht është 15 javë. Provimet përfundimtare të cdo semestri nuk përfshihen në kohëzgjatjen e semestrave. Në raste të nevojshme kohëzgjatja normale semestrave mund të zgjatet me vendim të Senatit të Shkollës së Lartë. Senati vendos dhe publikon cdo vit, fillimin e vitit akademik dhe kalendarin e provimeve. Në pushimet zyrtare nuk zhvillohet mësim ose provime. Mësimet dhe provimet mund të zhvillohen ditën e shtunë ose të dielë, vetëm në rast se cmohet e nevojshme, me propozim të njësisë përkatëse që ofron lëndën dhe me miratim të Këshillit të Administrimit të Shkollës së Lartë.

Kohëzgjatja e Arsimimit, Forma dhe Gjuha

NENI 11 – Kohëzgjatja normale e përfundimit të studimeve bachelor është gjashtë semestra. Periudha maksimale e studimeve është dyfishi i kohëzgjatjes normale të studimeve.

Procesi i arsimimi përbëhet nga leksionet, projektet dhe puna në studio, punimet në laborator dhe atelie, praktikat, punimet në terren, seminare, punimi i diplomimit dhe punime të tjera të ngjashme, të parashikuara në programin mësimor.

Përveç rasteve kur vendoset ndryshe dhe përveç klasës përgatitore, kohëzgjatja e cdo lënde, projekteve zbatuese, laboratorëve dhe veprimtarive të ngjashme të saj, është një semestër.


Gjuha e mësimdhënies në Shkollën e Lartë “Hëna e plotë” (Bedër) është Shqip, Anglisht dhe Turqisht.

Me propozim të Këshillit të Fakultetit dhe miratim të Senatit lëndë të caktuara mund të zhvillohen në një gjuhë të ndryshme nga ajo e programit të studimit.

Programet Arsimore

NENI 12

a) Arsimimi në fakultetet dhe departamentet e Shkollës së Lartë “Hëna e plotë” (Bedër) zhvillohet në përputhje me kërkesat e legjislacionit shqiptar në fushën e arsimit të lartë si dhe të Kartës së Bolonjës Programet mësimore të departamenteve mund të hyjnë në fuqi vetëm pasi Senati ka miratuar vendimet përkatëse të Këshillit të Fakultetit për hapjen e këtyre programeve. Lëndët me zgjedhje të programeve mësimore përbëhen nga lëndët me zgjedhje që hapen në fillim të semestrit nga departamenti për studentët e tij dhe nga lëndët me zgjedhje të hapura nga departamentet e tjera

 SHKOLLA E LARTË HËNA E PLOTË-BEDËR	RREGULLORJA STUDIMEVE TË CIKLIT TË PARË				
	DHE PROVIMEVE				
	Kodi i dokumentit	Data e publikimit	Nr. i përditësimit	Data e përditësimit	Faqe/Total
BU-REG-004-AL	01.10.2012	0	0	4 / 11	

b) Arsimimi bëhet në pajtim me programin mësimor dhe duke respektuar radhën e parashikuar në këtë program. Duke filluar nga semestri i tretë, studentët që kanë kaluar me sukses të gjitha lëndët e semestrave të kaluar dhe kanë një mesatare prej të paktën 3.00, me miratim të këshilltarit, mund të marrin një lëndë me zgjedhje të një viti më të lartë, ndërsa ata studentë që kanë një mesatare prej të paktën 3.50 mund të marrin dy lëndë me zgjedhje.

c) Studenti i cili pas regjistrimit paraqet një dokument të një institucioni të arsimit të lartë në të cilin tregohet se ka përfunduar me sukses një ose më shumë lëndë, mund të kërkojë përjashtimin nga ndjekja e atyre lëndëve. Këshilli i Administrimit të Fakultetit përkatës shqyrton kërkesën dhe nëse mendon se njohuritë që studentin ka përfituar në atë lëndë janë të mjaftueshme, mund ta çlirojë studentin nga detyrimi për të ndjekur lëndën. Në këtë rast, Këshilli i Administrimit të Fakultetit vendos se cilat lëndë janë të detyrueshme për t'u ndjekur nga studentin.

d) Në rast se studentin nuk ka mundur të ndjekë lëndët të cilat duhet t'i ndiqte normalisht gjatë semestrit, për shkaqe të konsideruara si të arsyeshme nga Këshilli i Administrimit të Fakultetit, atëherë ai mund të marrë lëndët pa parakushte (lëndë jo domosdoshmërisht të lidhura me njëra-tjetrën) në semestrin pasardhës. Studentin vijon studimet duke marrë fillimisht lëndët në të cilat ka rezultat jo të suksesshëm ose që nuk i ka marrë gjatë semestrave të mëparshëm. Puna praktike e përfshirë në programin e studimit zhvillohet nga njësitë përkatëse në kuadër të parimeve të përcaktuara, në përputhje me karakteristikat e arsimit të çdo departamenti.

Lëndët me Parakushte (lëndë të lidhura me njëra-tjetrën)

NENI 13 - Parakushtet për ndjekjen e lëndëve të caktuara përcaktohen nga departamentet përkatëse dhe pasqyrohen në programin mësimor.


Regjistrimi në një Lëndë, Lënia e Lëndës dhe Detyrimi për Frekuentim

NENI 14

a) Çdo student ka detyrimin për të marrë pjesë në leksionet, aplikimet, laboratorët, projektet, seminarët, atelietë, punimet e diplomimit dhe punimet e ngjashme të semestrit që është duke ndjekur, brenda kufijve të përcaktuar më poshtë.

b) Në rastet e përsëritjes ose të ndjekjes për herë të parë të leksioneve, laboratorit, projekteve dhe të aktiviteteve të ngjashme të barasvlefshme me leksionet, studentët duhet të regjistrohen më parë në lëndët në të cilat kanë marrë notën D- dhe F. Pasi i kanë zgjedhur këto lëndë atëherë mund të marrin dhe lëndë të tjera. Fillimisht merren lëndët e semestrave të shkuar, të cilat janë vlerësuar me D- dhe F.

c) Studentin, pasi të ketë marrë miratimin e këshilltarit, brenda dy javëve që nga fillimi i çdo semestri, mund të tërhiqet nga një ose më shumë lëndë, mund të ndryshojë lëndët e marra me lëndë të tjera ose mund të regjistrohet në lëndë të tjera.

 SHKOLLA E ARTË HËNA E PLOTË-BEDËR	RREGULLORJA STUDIMEVE TË CIKLIT TË PARË DHE PROVIMEVE				
	Kodi i dokumentit	Data e publikimit	Nr. i përditësimit	Data e përditësimit	Faqe/Total
	BU-REG-004-AL	01.10.2012	0	0	5 / 11

d) Studenti ka detyrimin të ndjekë të paktën 70% të lëndëve teorike dhe të paktën 80% të laboratorit dhe aplikimit. Studentët të cilët tejkalojnë këto norma nuk hyjnë në provimin përfundimtar semestral.

Punimi i Diplomimit

NENI 15 - Bërja e një punimi të detyrueshëm të diplomimit nga ana e studentit në përputhje me programin e arsimimit, i cili tregon arritjen e një niveli profesional të dëshiruar, vendoset nga ana e organeve kompetente të njësive përkatëse akademike. Kushtet e kryerjes së punimit, afati i dorëzimit, provimi dhe vlerësimi i punimit përcaktohet nga këto organe. Punimi i diplomimit përfshihet si lëndë e semestrit të gjashtë në programin mësimor. Punimi i diplomimit mund të parashikohet edhe në përmbajtjen e një lënde të caktuar. Temat mbi punimin e diplomimit mund t'i jepen studentëve edhe në semestrat paraardhës, bazuar në kushtet e përcaktuara.


Notat, Provimet dhe Kalueshmeria

Notat

NENI 16 - Për çdo lëndë të ndjekur, studentit vlerësohet nga pedagogu në përfundim të semestrit me një nga notat e mëposhtme

Pikët	Notat sipas Sistemit Shqiptar	Nota Shkronjore	Koefficienti
91-100	10	A	4.00
85-90	10	A-	3,66
80-84	9	B+	3,33
75-79	8	B	3.00
70-74	8	B-	2,66
65-69	7	C+	2,33
60-64	7	C	2.00
55-59	6	C-	1,66
50-54	5	D+	1,33
45-49	5	D	1.00
40-44	4	D-	0,66
0-39	0	F	0.00

*Pikët në sistemin 0-100, të cilat tregohen në transkript

 SHKOLLA E LARTË HËNA E PLOTË-BEDËR	RREGULLORJA STUDIMEVE TË CIKLIT TË PARË DHE PROVIMEVE				
	Kodi i dokumentit	Data e publikimit	Nr. i përditësimit	Data e përditësimit	Faqe/Total
BU-REG-004-AL	01.10.2012	0	0	6 / 11	

Nota të cilat nuk llogariten në mesatare

I- Me Mangësi

S- Mjaftueshem

T- Transferuar

U- Pamjaftueshem

P- Në Vijim

EX- Perjashtuar nga Detyrimi

NI- Nuk ka marrë pjesë

NA - Nuk vazhdon

Nota (I) jepet nga ana e pedagogut të lëndës për atë student i cili për shkak të një sëmundjeje ose të ndonjë shkakut tjetër të arsyeshëm, nuk ka mundur të plotësojë kushtet e lëndës edhe pse ka qenë i suksesshëm gjatë semestrit. Në rast se studenti ka marrë në një lëndë të caktuar notën (I), ai është i detyruar që brenda 15 ditëve nga dita e dorëzimit të notave në Sekretarinë Mësimore, të plotësojë mangësitë, në mënyrë që të marrë një notë. Nota e cila do të jepet në vend të notes (I) miratohet me vendim të Këshillit të Administrimit të Fakultetit. Përndryshe, nota (I) shndërrohet në notën (F). Megjithatë, në rastet e një sëmundjeje të gjatë ose në raste të ngjashme, me propozim të Përgjegjësit të Departamentit dhe me miratim të Këshillit të Administrimit të Fakultetit, kohëzgjatja e notës (I) mund të vazhdojë deri në fillimin e periudhës së regjistrimeve në semestrin pasardhës.

Nota (S), i jepet studentit në lëndët në të cilat ai ka qënë i suksesshem, por që nuk llogariten në mesatare.

Nota (T) jepet në rastet e transferimit horizontal nga një institucion tjetër i arsimit të lartë ose në rastet kur pranohet rezultati i një lënde të kaluar me, barazvlefshmëria e së cilës pranohet me propozim të Përgjegjësit të Departamentit dhe miratim të Këshillit të Administrimit të Fakultetit. Nota (T) nuk merret parasysh në llogaritjen e mesatares.


Për sa i përket lëndëve të marra gjatë programeve të shkëmbimit të studentëve, Këshilli Administrativ i Fakultetit përkatës vendos në lidhje me barazvlefshmerinë e krediteve dhe të notave të marra në këto lëndë.

Nota (U), i jepet studentit në lëndët në të cilat ai ka qënë i pasuksesshëm, por që nuk llogariten në mesatare.

Nota (P), i jepet studentit në lëndët në vazhdim të cilat nuk llogaritet në mesatare.

Nota (EX) i jepet studentit i cili përjashtohet nga marrja e një lënde në vijim të një provimi të organizuar nga departamenti në ato lëndë të përcaktuara nga ana e Senatit. Studentit në fjalë nuk i njihen kredite nga lënda e marrë. Nota (EX) nuk llogaritet në mesatare, por pasqyrohet në listën e notave.

Nota (NI) jepet me qëllim përshkrimin e lëndëve në të cilat është regjistruar studentit, por që nuk llogariten në mesataren e notave. Kjo notë paraqitet në listën e notave të studentit së bashku me

 SHKOLLA E LARTË HËNA E PLOTË-BEDËR	RREGULLORJA STUDIMEVE TË CIKLIT TË PARË				
	DHE PROVIMEVE				
	Kodi i dokumentit	Data e publikimit	Nr. i përditësimit	Data e përditësimit	Page/Total
BU-REG-004-AL	01.10.2012	0	0	7 / 11	

notën shkronjë që ai ka marrë në atë lëndë. Ngarkesa e lëndëve të cilat kanë këtë status përfshihen në grupin e lëndëve të përcaktuar në nenin 14 dhe nuk përdoren në procedurat e përlllogaritjes së lëndëve të programit ose p rogrameve në të cilat studenti është i regjistruar. Lënda në të cilën studenti ka marrë notën (NI), nuk mund të përsëritet.

Nota (NA) i jepet nga pedagogu përkatës i lëndës, studentëve të cilët për shkak se nuk kanë zbatuar rregullat në lidhje me frekuentimin e lëndës ose nuk kanë plotësuar kushtet në lidhje me praktikën ose aplikimin e lëndëve, kanë qënë të pasuksesshëm. Në llogaritjen e mesatares, nota (NA) koniderohet si (F)

Studentet kalues, jo kalues ,të Suksesshëm, të Nderit dhe të Nderit të Lartë

NENI 17-

a) Nëse në një lëndë studenti vlerësohet me C (2.00) ose me një notë më të lartë, atëherë ai është kalues. Në rast se në një lëndë, studenti vlerësohet me (D- dhe F), atëherë ai është jokalues dhe është i detyruar të përsërisë lëndën. Në rast se mesatarja e përgjithshme e notave është të paktën (2.00) dhe nuk ka notë (D- dhe F), studenti quhet i suksesshëm.

b) Në rast se rast në fund të semestrit të katërt, mesatarja e përgjithshme e notave të studentit është më e ulët se 1.80, atëherë ai merr statusin e provës. Studenti i cili ndodhet në statusin e provës, duhet të përsërisë lëndët e hapura të semestrave të kaluar, në të cilat ai ka marrë notë F, D-, D, D+, C-. Studentit nuk i njihet e drejta e marrjes së lëndëve të reja të hapura në semestrin e pestë. Në mënyrë që ai ta kalojë këtë status duhet që të arrijë ose të kalojë nivelin prej (1.80) të mesatares së përgjithshme të notave, në rast të kundërt ai nuk lejohet të marrë lëndë nga lart.

c) Nëse në përfundim të semestrit, studentët kanë përfunduar me sukses të gjitha lëndët dhe kanë një mesatare semestrale prej 3.00-3.49 renditen në listën e “Nderit”, ndërkohë ata që kanë një mesatare prej 3.50-4.00, renditen në listën e “Nderit të Lartë”.


Përmirësimi i Mesatares së Përgjithshme

NENI 18- Studenti i cili dëshiron të përmirësojë notën mesatare të përgjithshme, mund të përsërisë lëndët e studiuara në vitet paraardhëse. Në llogaritjen e mesatares do të merret parasysh nota e fundit që ka marrë studenti në atë lëndë.

Nota e Suksesshme

NENI 19

a) Nota e suksesshme në një lëndë, përcaktohet nga punimet përkatëse të kryera gjatë atij semestri (provimet e gjatë semestrit, provimet e shkurtra, punimet në terren, aplikimet, detyrat,

 SHKOLLA E LARTË HËNA E PLOTË-BEDËR	RREGULLORJA STUDIMEVE TË CIKLIT TË PARË				
	DHE PROVIMEVE				
	Kodi i dokumentit	Data e publikimit	Nr. i përditësimit	Data e përditësimit	Faqe/Total
BU-REG-004-AL	01.10.2012	0	0	8 / 11	

projektet, ateljet, seminarët, pjesëmarrja, laboratorit etj) së bashku me notën e marrë në provimin përfundimtar. Brenda javës së parë të cdo semestri, pedagogët duhet të publikojë sistemin e vlerësimit në lëndët përkatëse.

b) Gjendja e suksesit e cdo lënde, i dorëzohet organeve administrative përkatëse, brenda të përcaktuar në kalendarin akademik dhe rezultatet publikohen nga Sekretaria Mësimore.

Sezoni i Provimeve

NENI 20

Sezoni i provimeve zhvillohet pas përfundimit të cdo semestri. Në rast se një provim nuk bëhet brenda sezonit për shkaqe të pranuar si të arsyeshme nga këshilli përkatës i administrimit, sezoni i provimeve mund të zgjatet për aq ditë sa nuk janë kryer provime brenda afatit normal.

Provimi i diplomimit zhvillohet gjatë javës pas sezonit të provimeve. Lëndët të cilat zhvillohen në laborator, aplikime dhe punimet në terren, do t'i kryejnë provimet në përfundim të kësaj periudhe. Në të njëjtën mënyrë do të kryhet edhe për lëndët për të cilat konsiderohet dhënia e të drejtës për një provim shtesë.

Programi dhe Vendi i Provimeve, Provimet Make-up


NENI 21 - Programit i provimeve përfundimtare semestrale, përcaktohet nga këshilli i administrimit të fakultetit përkatës dhe duhet të publikohet të pakten dy javë para fillimit të sezonit të provimeve. Provimet kryhen në ambientet e Shkollës së Lartë, në ditën, vendin dhe orën e caktuar në program. Provimet e lëndëve të cilat zhvillohen në terren ose me aplikimi, mund të bëhen edhe jashtë godinës së Shkollës së Lartë

Provimet përfundimtare të semestrit nuk kanë provim make-up. Studentëve, të cilët për shkaqe të arsyeshme nuk mund të marrin pjesë në provimin përfundimtar semestral, u ruhet e drejta e provimit. Studentët të cilët nuk kanë hyrë në provimin përfundimtar semestral, duhet të paraqesin pranë Sekretarisë Mësimore, brenda një jave nga data e provimit përkatës, kërkesën e shoqëruar me dokumentet të cilat provojnë ekzistencën e shkaqeve të arsyeshme. Studentët të cilëve u është pranuar kërkesa me vendim të Këshillit të Administrimit të Fakultetit përkatës, mund të përdorin të drejtën e hyrjes në provim gjatë sezonit kur këto lëndë do të kryejnë provime në semestrat pasardhës.

Forma e Provimit

NENI 22: Provimet zakonisht bëhen me shkrim. Pedagogu i lëndës mundet që të vendosë të bëjë provimin me gojë, në formë projekti ose detyrë kursi. Në këtë rast është e detyrueshme që vendimi i shefit të departamentit, të publikohet jo më vonë se dy javë nga fillimi i semestrit.

Provimi përgatitet dhe drejtohet nga pedagogu i lëndës përkatëse. Në rast se pedagogu përgjegjës nuk ndodhet në ambientet e Shkollës së Lartë ditën e provimit, atëherë shefi i seksionit përcakton

 SHKOLLA E LARTË HËNA E PLOTË-BEDËR	RREGULLORJA STUDIMEVE TË CIKLIT TË PARË DHE PROVIMEVE				
	Kodi i dokumentit	Data e publikimit	Nr. i përditësimit	Data e përditësimit	Faqe/Total
	BU-REG-004-AL	01.10.2012	0	0	9 / 11

se kush do ta bëjë provimin dhe kjo i bëhet e ditur shefit të departamentit. Të gjithë pedagogët dhe asistentët mund të ngarkohen me detyrë, me qëllim të sigurimit të mbarëvajtjes së provimeve.

Ankimimi ndaj Rezultateve të Provimeve

NENI 23 - Në rast se studenti ka ankesa ndaj rezultatit përfundimtar të një provimi semestral, ai ka të drejtë që brenda një jave nga dita e publikimit të rezultateve të paraqese një ankesë tek Sekretaria Mësimore. Ankimi shqyrohet nga pedagogu i lëndës mbi gabimet materiale, dhe me propozim të këshillit të departamentit përkatës, Këshilli i Administrimit të Fakultetit merr vendim përfundimtar.

Arsimimi gjatë Semestrit të Verës

NENI 24 - Procesi mësimor gjatë semestrit të verës do të zhvillohet në përputhje me “Rregulloren e Semestrit të Verës”.

Vlerësimet

NENI 25: Vlerësimi i mesimit, aplikimit, laboratorit, projekteve, seminareve dhe punimeve përmblyëse ngë pikëpamja akademike bëhet në bazë të njësisë matëse orë. Vlera e krediteve të një lënde përbëhet nga orët e plota teorike në javë dhe gjysma e orëve javore të aplikimit, laboratorit, projektit dhe punës në atelje.


Mesatarja e Përgjithshme e Notave

NENI 26 - Mesatarja e përgjithshme e notave nxirret nga shumëzimi i notës përfundimtare të marrë nga lënda ose nga laboratorit, projektet, ateljetë, seminarët ose punët e ngjashme të cilët kanë vlerën e një lënde, me orët e krediteve të lëndës përkatëse dhe shuma që del pjesëtohet me shumën e përgjithshme të krediteve. Shuma që del nga pjesëtimi rumbullakoset me dy shifra pas presjes dhe përbën mesataren e përgjithshme të notave.

Përfundimi i Studimeve dhe Diploma

NENI 27

a) Studenti, i cili ka kaluar me sukses në të gjitha lëndët e paraqitura në programin mësimor të Fakultetit dhe ka në mesatare të përgjithshme të notave të paktën (2.00) dhe nuk ka asnjë notë të vlerësuar me (F); ka përfunduar të gjitha punimet e parashikuara në këtë rregullore, atëherë pajiset me diplomën e përcaktuar në nenin 3 të rregullores. Studentët të cilët në prag të diplomimit kanë jo më shumë se dy nota (F) dhe ata që nuk kanë asnjë lëndë të pasuksesshme, por mesatarja e tyre është nën (2.00), u jepet e drejta të përdorin vetëm një herë të drejtën e

 SHKOLLA E LARTË HËNA E PLOTË-BEDËR	RREGULLORJA STUDIMEVE TË CIKLIT TË PARË				
	DHE PROVIMEVE				
	Kodi i dokumentit	Data e publikimit	Nr. i përditësimit	Data e përditësimit	Faqe/Total
	BU-REG-004-AL	01.10.2012	0	0	10 / 11

provimit shtesë për jo më shumë se dy lëndë në të cilat kanë marrë (D+) dhe (D) në përfundim të atij semestri. Në këtë rast, nota e marre në këtë provim zëvendëson notën e marrë më parë.

b) Studentët të cilëve iu njihet e drejta e diplomimit, në mënyrë që të tërheqin diplomën duhet të paraqesin në njësitë kompetente dokumentet me të cilat tregojnë se nuk kanë detyrime ndaj Shkollës së Lartë.

Dispozita të Ndryshme

Ruajtja e Lejeve dhe e të Drejtave

NENI 28

a) Studenti mund t'i jepet leje për një periudhë maksimale prej 4 semestrash (për shkaqe të arsyeshme dhe të drejta), me anë të vendimit të Këshillit të Administrimit të Fakultetit. Kërkesa për leje duhet të bëhet brenda 30 ditëve nga fillimi i vitit akademik dhe mund t'i jepet vetëm 2 semestra leje për kërkesë. Studenti është i detyruar të paguajë 1/3 të pagesës semestrale, për çdo semester që ka kërkuar leje.

b) Në rast sëmundjeje, katastrofash natyrore, shkaqeve ekonomike, burgosjes dhe revokimit të shtyrjes së thirrjes ushtar, apo shkaqe të tjera të cilat mund të cilësohen të përshtatshme dhe të justifikuar nga Këshilli i Administrimit të Fakultetit, studentit mund t'i jepet leje edhe gjatë semestrit. Në këto raste studentit nuk i kthehet pagesa e studimit që ka kryer.

c) Studenti i cili kërkon leje në kushtet e parashikuara në pikën (b), duhet t'i drejtohet më kërkesë Sekretarisë Mësimore brenda 20 ditëve nga dita e vërtetimit të ngjarjes dhe të paraqesë dokumentet e provës të ekzistencës së faktit. Në rast se shkaqet vazhdojnë, Këshilli i Administrimit mund të vendosë zgjatjen e lejes.


Studenti i cili ka marrë leje nuk mund të marrë pjesë në mësim dhe nuk mund të hyjë në provimet e fundvitit.

d) Lejet afatgjata, nuk përfshihen në kohëzgjatjen e arsimimit me kusht që të jetë e parashikuar në vendim.

e) Përdorimi i emrit dhe simboleve të Shkollës së Lartë në aktivitetet artistike të organizuara nga studentët ose një grupi studentesh, lejohet vetëm me miratim paraprak të Rektoratit.

Largimi nga Shkolla e Lartë

NENI 29 - Studentët të cilët do të largohen nga Shkolla e Lartë "Hëna e plotë" (Bedër), më dëshirën e tyre, duhet t'i drejtohen me shkresë dekanatit të fakultetit ku ata kanë studiuar. Rregjistrimi i këtyre studentëve fshihet vetëm në rast se ata paraqesin dokumentet të marra nga njësitë përkatëse, të cilat dëshmojnë se nuk kanë asnjë detyrim ndaj Shkollës së Lartë. Studenti të cilit i është fshirë rregjistrimi, në bazë të kërkesës së tij, duhet t'i jepen dokumenta të cilat japin

 SHKOLLA E LARTË HËNA E PLOTË-BEDËR	RREGULLORJA STUDIMEVE TË CIKLIT TË PARË DHE PROVIMEVE				
	Kodi i dokumentit	Data e publikimit	Nr. i përditësimit	Data e përditësimit	Faqe/Total
	BU-REG-004-AL	01.10.2012	0	0	11 / 11

informacion mbi arsimin e ndjekur prej tij deri në atë moment, diplomat e dorëzuar në fillim të studimeve dhe dokumente të tjera. Studenti është i detyruar të shlyejë detyrimet e tij për të gjithë semestrin në të cilin ndodhet.

Studentët e Dërguar në Kuadër të Bashkëpunimeve me Universitetet e Huaja

NENI 30 - Shkolla e Lartë “Hëna e plotë” (Bedër), në përputhje me marrëveshjeje që mund të bëhen me universitetet jashtë, në kuadër të programeve të shkëmbimit të studentëve, mund të dërgojë studentët e saj për një ose dy semestra në universitetet e huaja me të cilat ka marrëveshje paraprake. Rregjistrimi i studentit në Shkolla e Lartë vazhdon edhe gjatë kësaj periudhe, e cila llogaritet në kohëzgjatjen e arsimimit.

Transferimi

NENI 31 – Studentët pasi kanë përfunduar të paktën dy semestra, mund të aplikojnë pranë Sekretarisë Mësimore brenda afateve të përcaktuara në kalendarin akademik , për t’u transferuar në një program tjetër brenda Shkollës së Lartë. Në periudhën dy semestrale nuk përfshihet klasa përgatitore.

Aplikimet pasi shqyrtohen nga departamenti ku studenti ka bërë kërkesë për tu transferuar, marrin formë të prerë me vendim të Këshillit të Administrimit të Fakultetit.

Programet Double Major dhe Minor

NENI 32 – Studentët, mund të ndjekin lëndët e programve të hapura nga departamentet e tjera që prej semestrit të tretë, në përputhje me kriteret e përcaktuara nga Senati. Studenti në përfundim të studimeve, përveç diplomës të departamentit ku është regjistruar pajiset edhe me diplomë të programit double Major ose me certifikatë të programit Minor.

Studentët me Bursë

NENI 33- Në mënyrë që bursa që përfitojnë studentët të vazhdojë edhe në vitet e ardhme, duhet që ata të plotësojnë kushtet e mëposhtme:

- a) Nuk duhet të marrin asnjë masë disiplinore
- b) Duhet të diplomohen brenda tre viteve
- c) Duhet të përmbushin kushtet e parashikuara në nenin 14 të kësaj rregulloreje.
- d) Duhet të përmbushin kriteret e suksesit në mësim, të përcaktuar në vendimet përkatëse të Këshillit të Administrimit të Shkollës së Lartë.

Në rast të kundërt, bursa e studimit ndërpritet në përfundim të vitit akademik që ndodhet student.

Hyrja në Fuqi

NENI 34 - Kjo rregullore hyn në fuqi në ditën që i paraqitet Këshillit të Lartë.

Zbatimi

NENI 35 - Zbatimi i kesaj rregulloreje garantohet nga Rektori i Shkollës së Lartë “Hëna e plotë” (Bedër).